



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION THE INDEPENDENT OF KOSOVO
UNIA NEZAVISNIH SIDIKATA KOSOVA

Nr. fiskal : 6 00 26 77 93

Adress: Rr. Nëna Terezë Nr.35 10000 Prishtinë

Tel / Fax: +381/ 222 - 859, Email: bspk@etuc.org; spklk01@gmail.com

Fenomeni i migracionit në Kosovë , sigurisht që është një qështje shqetësuese edhe për ne si përfaqësues të punëmarrësve.

Shteti i së drejtës dhe shteti zhvillimor do të ishte i mangët pa një gjendje sociale solide. Ne duam dhe angazhohemi për rritje dhe zhvillim ekonomik, por kjo nuk mundë të bëhet në kurriz të punëtorëve. Mendojmë se nuk mundë të ketë zhvillim të mirfilltë dhe të qëndrueshëm të bizneseve e as zhvillim ekonomik pa u respektuar të drejtat e punëtorëve.

Në Kosovë, kemi ligjet bazike që rregullojnë raportet pra të drejtat dhe obligimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve, por kemi problem në implementimin e tyre.

Bizneset duhet t'i përshtaten konkurrencës dhe tregut të punës, por jo vetëm në aspektin e përmirësimit të kualitetit dhe cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve të tyre, por edhe në aspektin e respektimit të të drejtave të punëtorëve që i angazhojnë.

Jemi dëshmitarë se punëtorët sidomos në sektorin privat çak edhe në aspektin gjinorë diskriminohen. Këtë, po e ilustruam vetëm me disa të gjetura tona nëpër disa kompani; punëtorët nuk paisein me Kontrata Pune, angazhohen 10-12 orë pune në ditë, nuk kanë ambient të përshtatshëm pune, nuk mundë ta shfrytëzojnë sipas ligjit pushimin ditorë, javorë, vjetorë etj, e çka është më e rënda nuk shpërblehen për punën që e bëjnë, për ti mbuluar të gjitha këto punëtorëve nuk u lejohet të organizohen pra të kenë sindikatë edhe pse këtë ua garanton ligji dhe Konventat ndërkombëtare.

Me një pagë minimale në lartësi prej 130-170€, nuk mundë të motivohet askush të punoj, pra, duhet të kemi kujdes që mos të krijojmë raste sociale edhe tek ata që punojnë.

Që punëtorët e kanë bartur dhe e bartin barrën më të madhe të papunësisë, varfrisë, informalitetit, nepotizmit dhe korrupsionit në Kosovë e dëshmon edhe procesi i privatizimit në Kosovë. Me rastin e privatizimit që ka ndodhë dhe po vazhdon e që nuk po dihet fundi, kanë ngel pa punë mbi 50.000 punëtorë, këta punëtorë kanë mbetur pa asnjë përkujdesje, i tërë shpërblimi për punën e tyre 10,20,30 vjeçare është 20% i shitjes së Kompanisë, të cilin kompenzim ka raste që nuk e kanë shfrytëzuar enda që nga viti 2003.

Në mesin e këtyre punëtorëve të mbetur pa punë, ka ekspert të profesioneve të ndryshme, që me një ritrajnim një pjesë e madhe e tyre kanë mundur ti përshtatën ekonomisë së tregut të punës .

Nga e gjithë ajo çka u tha më lartë, fatkeqësisht pra puntorët janë kandidat potencial për megrim.

Për këtë arsye nevojitet angazhim i sinqert, serioz dhe këmbëngulës i të gjithëve që këtë fenomen ta vëjmë nën kontrollë. Mendojmë se kjo mundë të bëhet duke respektuar ligjet, duke ngritur nivelin e zhvillimit të dialogut social në të gjitha nivelet, krijimi i vendeve të qëndrueshme të punës, përshtatja e arsimit nevojave të ekonomisë së tregut punës, identifikimi i sektorve që do të absorbaonte dhe kërkonte fuqi punëtore, hartimi i strategjisë nacionale për zhvillim ekonomik afatëshkurtër, afatëmesëm dhe afatëgjatë,

Prishtinë, 10.12.2015

Alush Sejdiu – N/Kryetar i BSPK-ës